VENDIM
Nr. 350, datë 7.6.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 612, DATË 5.9.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT 'PËR AKCIZAT'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 108 e 109, të ligjit nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit 'Për akcizat'", të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

Neni 1

Në fund të shkronjës "a", të pikës 3, të nenit 43, pas fjalëve "... në këtë dispozitë ..." shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

", ... me përjashtim të akcizës së paguar për produktin "Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike", të klasifikuar në kreun 2711 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, e cila do të rimbursohet plotësisht.".

Neni 2

Aneksi 10, "Tabela referuese e disa normativave të harxhimit të lëndës djegëse", bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me aneksin 10, "Tabela referuese e disa normativave të harxhimit të lëndës djegëse", që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 3

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKS 10

TABELA REFERUESE E DISA NORMATIVAVE TË HARXHIMIT TË LËNDËS DJEGËSE

Agro-industria

Nr.	Aktiviteti	Procesi teknologjik	Sasia e lëndës djegëse për 1 ton prodhim		
			Mazut	Solar	Gaz GLN
1	Përpunim qumështi	Sterilizim pasterizim	26–32	24–29	
2	Prodhim ëmbëlsira	Pjekje	42–53	39–48	

3	Prodhim birre	Sterilizim, zierje malti	26–32	24–29	Sipas kartës teknologjike të miratuar
4	Prodhim pije alkoolike	Sterilizim, pjekje	26–32	24–29	
5	Përpunim fruta-perime	Sterilizim, pasterizim	26–32	24–29	
6	Prodhim vaji	Sterilizim	26–32	24–29	

Nr.	Aktiviteti	Procesi teknologjik	Sasia e lëndës djegëse për 1 ton prodhim			
			Gazoil	Mazut	Solar	Gaz GLN
1	Prodhim buke	Pjekje	45–50	42–53	39–48	Sipas kartës teknologjike të miratuar

Serrat me ngrohje

Nr.	Aktiviteti	Procesi teknologjik	Sasia e lëndës djegëse litër/1 dynym sipërfaqe		
			Mazut	Solar	Gaz GLN
1	Prodhim perime	Ngrohje e ambientit në	10 000	10 000	Sipas kartës teknologjike të miratuar

Industria

Nr.	Aktiviteti	Proceset teknologjike	Gazoil D1 ose D2	Sasia e lëndëve djegëse për njësi të produktit final		
				Solar ose mazut	Koks nafte	Gaz GLN
1	Prodhim tullash dhe tjegullash me pjekje termike, etj.	Ngrohje, tharje dhe pjekje të tullave dhe tjegullave		Sipas kartës teknologjike të miratuar jo më shumë se 4 kg, solar për 1 kV produkt final	Sipas kartës teknologjike të miratuar	Sipas kartës teknologjike të miratuar
2	Prodhim çimento			Sipas kartës teknologjike të miratuar	Sipas kartës teknologjike të miratuar	Sipas kartës teknologjike të miratuar
3	Riciklim i plastikës, qelqit dhe të përzier			Sipas kartës teknologjike të miratuar		Sipas kartës teknologjike të miratuar
4	Prodhim lingotash	Shkrirja e skrapit		Sipas kartës teknologjike të miratuar	Sipas kartës teknologjike të miratuar	Sipas kartës teknologjike të miratuar
5	Prodhim barnash		Sipas kartës teknologjike të miratuar	Sipas kartës teknologjike të miratuar		Sipas kartës teknologjike të miratuar
6	Rafineri	Përpunim i naftës bruto		Sipas kartës teknologjike të miratuar		Sipas kartës teknologjike të miratuar

*Shënim. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, do të bëjë përditësimin e normativave të harxhimit të lëndëve djegëse për të gjithë sektorët e industrisë që përfitojnë nga skema e rimbursimit të akcizës.